

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

Zotërinj dhe zonja deputete,

Zonja drejtuese e seancës,

Të dashur qytetarë dhe qytetare,

Dua të theksoj që në fillim se skena e këtij parlamenti sot është më e veçanta në tërë historinë e tij. Aty ku është karrigia e Kryeministrit, aty qëndron sot Charles McGonigal-i, kurse ai që duhej të ishte aty është iluziv, sepse i ka hyrë lepuri në bark dhe ka një frikë të tmerrshme nga ajo që i ka bërë vetes së tij. Atë nuk e zë vendi, sepse ka kryer krime të shëmtuara kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai sot mirë është të sjellë një barelë këtu ose një shtrat, sepse i ka rënë fuqia te këmbët. Ai sot bëri mirë që nuk doli aty, sepse nuk ka si të paraqitet para shqiptarëve me krimin e shëmtuar transatlantik që ka kryer. Jam këtu për një seri pyetjesh. Janë 13, por duhet të jenë 130, të cilave duhet t'u përgjigjet komisioni hetimor parlamentar. Pa marrë përgjigje për këto pyetje, Shqipëria do të ketë kaos dhe vetëm kaos dhe përgjegjësia do të bjerë mbi atë që ka ulur sot në vendin e tij, tradhtarin e kombit amerikan, vrasësin me pagesë të opozitës shqiptare, Charles McGonigal-in. Zonja dhe zotërinj, Është e pashembullt në histori që një vend partner t'i rekrutojë dhe t'i korruptojë kryezbuluesin një vendi që udhëheq botën e lirë, që udhëheq NATO-n dhe që është udhëheqësi kryesor i paqes dhe i sigurisë mbi Tokë. Është e pashembullt që një Kryeministër të vërë në dispozicion të tij të gjithë shtetin për të bërë luftën më monstruoze, më të turpshme kundër pluralizmit dhe opozitës. Ke kryer krim në SHBA, dhe po të lexoj se çfarë tha mbrëmë prokurori i Përgjithshëm në senatin amerikan. Prokurori i Përgjithshëm i SHBA-ve tha: "Ata që paguajnë punonjësit tanë për interesat e qeverisë së tyre, cenojnë sigurinë tonë kombëtare". Punonjës, theksoi ai, pale kryezbuluesin.

Ndaj, hiq çdo iluzion, je nën hetim, ke kryer krim. Sa do të të mbajë imuniteti diplomatik? Por do bëjmë gjithçka që të ta heqim ty atë. Ti ke vazhduar me McGonigal-in sistemin e gjobave të 20%-shit, që e ushtroje me pasion të çmendur. (Ndërhyrje nga salla pa mikrofon) Mos fol, se edhe ti më dukesh McGonigal. Damian, ti fole, apo foli Taulanti? Cili foli? Se edhe ju, McGonigal jeni të dy. Ju të dy jeni Duçka dhe Neza. Po, po, mos flisni kur flas unë! Unë, kur flisni ju, ju dëgjoj, prandaj mos flisni kur flas unë. Më lini të flas! (Ndërhyrje nga salla pa mikrofon) Serioz?! A nuk je ti ai që tha se t'i ka ngarkuar Rama ato detyra? Tani i paske ndërruar fjalët! Sigurisht t'i ka ngarkuar, sepse do t'i varje medalje dhe dekorata atij, kurse ti tjetri do t'i çoje biznesmenët. Vendosi një sistem shushunjash, të paprecedent në një vend, ndaj biznesmenëve, vetëm e vetëm që t'i nënshtroni dhe t'i rripni ata. Këtu në parlament keni qarkulluar mashtrimin, sepse janë 152 të blacklistuar, 187 të blacklistuar. Çfarë bënit ju me këtë? Krijonit vetëm background-in e gjobave që ekipi "Rama-McGonigal" vendoste nëpërmjet Nezës, Duçkës e të tjerë. Çfarë ishte ajo klimë që krijonit? Ndaj, po ju them përsëri: stop manipulimit në marrëdhëniet shqiptaro-amerikane. Ta dinë shqiptarët se këta së bashku me Yuri Kim-in bënë njoftimin për largimin e ambasadores amerikane, me qëllimin e vetëm që të zgjatej qëndrimi i saj në Shqipëri. Ta dini mirë që ne jemi këtu për të bërë transparencë, dhe nuk ka gjë në botë që na pengon.

Ne besojmë se me Shtetet e Bashkuara na lidhin miqësi dhe vlera të jashtëzakonshme, por besojmë se ata që manipulojnë me këto marrëdhënie, janë armiqtë më të egër të këtyre marrëdhënieve. Po e këtij manipulimi ishte deklarata e të gjitha këtyre zonjave, e cila “na duhej diku për ta paraqitur kundër këtij Berishës, që të gjitha gratë e dënojnë, sepse shpif”. Unë i kisha denoncuar me të drejtë aferat dhe do t’i denoncoj pa asnjë lloj hezitimi kur ato janë kundër interesave të vendit, shoqërisë dhe kombit tim. Vazhdoni ju me kurthe të tjera, por të gjitha do t’jua zbërthej. Do të vijë dita që ta mësojë edhe shqiptari i fundit se çfarë malli jeni ju, çfarë përfaqësoni ju, se çfarë mafie e rrezikshme, se çfarë njerëzish jeni, që nuk keni interes tjetër përveç pasurimit tuaj, se jeni të aftë të bëni gjithçka kundër kundërshtarëve. Në traditën atërore, kundërshtarët janë për t’u zhdukur dhe monizmi është regjimi më i mirë. Përdorët McGonigal-in për të certifikuar, për të mbyllur vjedhjet tuaja, për të mbyllur korrupsionin, për të sulmuar antikorrupsionin në Shqipëri, për të sulmuar ata që ditë e natë kanë denoncuar dhe denoncojnë krimin. McGonigal-i shkoi aty ku e meriton, si tradhtar i kombit të tij. E sigurt që edhe ti do të shkosh atje ku e meriton, jo vetëm si tradhtar, por edhe si armik i egër i demokracisë shqiptare, bashkë me çetën tënde.

Pra, janë 13 pyetje, por mund të ishin 130. Ndaj, kërkoj me çdo kusht krijimin e komisionit, me të drejtën kushtetuese. Sikundër e vlerësoj aktin tuaj, zonjë, që ngrite parlamentin për të mbajtur zi për tri qytetare, për tri nëna dhe vajza. Gjithashtu, theksoj se ai vrasës serial ishte një patronazhist juaji, ishte turpi juaj, ishte informatori i policisë suaj, ishte njeriu që e liruati dhe keni përgjegjësi të madhe për këtë.